



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

V E N D I M

**PËR REGJISTRIMIN E KANDIDATIT PËR KRYETAR TË BASHKISË ELBASAN TË
PROPOZUAR NGA KOALICIONI "ALEANCA PËR SHQIPËRINË EUROPIANE" Z. GLEDIAN
ILIAZ LLATJA PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË VITIT 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 15.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për regjistrimin e kandidatit për kryetar të Bashkisë **Elbasan z. Gledian Iljaz Llatja**, të propozuar nga koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019.

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa "a", neni 67, pika 2, neni 165, pika 3 neni 72 dhe neni 73, pika 1, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane" si dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

V Ë R E N:

Me vendimin e KQZ-së nr.251, datë 07.05.2019, është regjistruar si subjekt zgjedhor, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019 koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane". Sipas marrëveshjes së Koalicionit "Aleanca për Shqipërinë Europiane",



Nr. 352 i Vendimit

Data 15.05.2019

Ora 11:00 e Vendimit

Për regjistrimin e kandidatit për kryetar të Bashkisë Elbasan të propozuar nga koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane", z. Gledian Iljaz Llatja për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019.

kryetari i Partisë Socialiste të Shqipërisë, z. Edi Rama do të jetë personi i cili do të autorizojë personat përgjegjës për të firmosur në emër të koalicionit kërkesën për rregjistrimin e kandidatëve për Kryetar Bashkie.

Në bazë të nenit 67, pika 2 dhe nenit 72 dhe 165, pika 3 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", Koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane" ka depozituar në KQZ kërkesën për rregjistrimin e **z. Gledian Iljaz Llatja** si kandidat për Kryetar të Bashkisë **Elbasan**.

Në bazë të nenit 67, pika 3, KQZ duhet të rregjistrojë kandidatët për kryetar apo për këshillin e bashkisë Shkodër, pasi Bashkia Shkodër, administrohet nga më shumë se një KZAZ.

Bashkëlidhur kërkesës është depozituar dhe dokumentacioni përkatës, si më poshtë listuar:

1. Kërkesë për rregjistrimin e **z. Gledian Iljaz Llatja** si kandidat për Kryetar të Bashkisë **Elbasan**;
2. Deklaratat e kandidatit i cili deklaron se gëzon të drejtën dhe vullnetin për të kandiduar për Kryetar në Bashkinë Elbasan, të propozuar nga Koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane" në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019;
3. Vërtetim i Kuvendit të Shqipërisë, nr. 1851/1. prot., datë 09.05.2019, sipas të cilit vërtetohet se Partia Socialiste, përfaqësohet nga 74 deputetë në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.
4. Kopje e letërnjoftimit të **z. Gledian Iljaz Llatja** sipas së cilës rezulton se **z. Gledian Iljaz Llatja** është me vendbanim në Bashkinë Elbasan;
5. Jetëshkrimin **Z. Gledian Iljaz Llatja** si kandidat për Kryetar të Bashkisë **Elbasan**;
6. Formularin e vetëdeklarimit, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".
7. Procesverbal i dorëzimit të dokumentave të kandidimit.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", verifikoi të dhënat në formularët e vetëdeklarimit për të kandidatit për kryetar bashkie. KQZ gjithashtu ka publikuar formularin e vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Nga verifikimi i të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit dhe informacionit të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve z. Gledian Iljaz Llatja, nuk është në kushtet e nenit 2, të ligjit nr. 138/2015, për refuzimin e tij si kandidat për kryetar bashkie, propozuar nga Koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 73, pika 1, të Kodit Zgjedhor, në mbledhjen e datës 15.05.2019, verifikoi dokumentacionin e kandidimit për kryetar z. Gledian Iljaz Llatja, në Bashkinë Elbasan, të depozituar nga Koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane" dhe konstatoi se ishte në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenin 67, pikat 2, neni 165 neni 72 dhe neni 73 të Kodit Zgjedhor.



Nr. 352 i Vendimit

Data 15.05.2019

Ora 11:00 e Vendimit

Për rregjistrimin e kandidatit për kryetar të Bashkisë Elbasan të propozuar nga koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane", z. Gledian Iljaz Llatja për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbështetur në nenin 23, pika 1, germa "a", nenin 67, pikat 2, 4, 5, dhe 6, nenin 72, dhe nenin 73, pika 1 të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë".

V E N D O S I:

1. Të regjistrojë si kandidat për kryetar në Bashkinë Elbasan për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, z. Gledian Iljaz Llatja të propozuar nga Koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane".
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare



Nr. 352 i Vendimit

Data 15.05.2019

Ora 11:00 e Vendimit

Për regjistrimin e kandidatit për kryetar të Bashkisë Elbasan të propozuar nga koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane", z. Gledian Iljaz Llatja për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019.